



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-122

Prishtinë, më 29 korrik 2013, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 KORRIK 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Glauk Konjufca dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Millosavleviq dhe Mufera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit, Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Sherif Konjufca dhe Nexhat Jashari;

Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 korrik 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 korrik 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 korrik 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare të mbahet të mërkurën me 31 korrik 2013, me këtë:

Rend dite:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes kornizë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, që rregullon aktivitetet e Bankës Evropiane për investime në Kosovë,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim - financimi i dytë shtesë për projektin e pastrimit të sektorit të energjisë dhe të bonifikimit të tokave - CLRP,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes financiare "ISTISNA-A" dhe marrëveshja për Agjencinë "ISTISNA-A" për financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevi-Mitrovicë, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për fshatin Zym i Hasit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të huajt,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale,

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shtetësinë e Kosovës,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për azil,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.

Kryesia e shtyu për muajin shtator hartimin e katër raporteve të agjencive të pavarura.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i propozim-Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Shqyrtimi i propozim-Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, u shty për muajin shator 2013.

2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, të përgatitur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me administratën e Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, sipas pasqyrave të paraqitura.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti dhe Industri lidhur me Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës - AKK

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nxori këto përfundime:

P Ë R F U N D I M

Kërkohe nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në bazë të nenit 25.4 të Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, në afatin sa më të shpejtë të mundshëm t'ia propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatët për dy anëtarë në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, të cilëve u përfundon mandati më 24.11. 2013.

P Ë R F U N D I M

Kërkohe nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që t'i rishqyrtojë rekomandimet e datës 24.7.2013 dhe ta paraqesë raportin me rekomandime.

4. Njoftimi për vizitën e realizuar në Gjermani nga Komisioni për Buxhet dhe Financa

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit, të realizuar në Gjermani, prej 9-15 qershor 2013.

5. Informimi për gjendjen në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi

Kryesia e shtyu për muajin shtator 2013 informatën për gjendjes në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi.

.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 9:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale